



REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Drenasit  
Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060/01- 21114 dt. 13. 05. 2022

Në bazë të nenit 52 të Ligjit nr. 03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 42 pika 42.2 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 12 pika 12.2 dhe nenit 21 pika 21.2 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës të Drenasit z. Milaim Hajdari, me dt. 20.05.2022 (e Premte ) duke filluar në ora 10:00, në sallën e Bordit të Drejtorëve të Komunës.

**THËRRET**  
**Mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa**

Mbledhja do të këtë:

**Rend dite:**

1. Procesverbal i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i mbajtur më dt. 20.04.2022.
2. Propozim Vendim për formimin e Komisionit Komunal të Aksionareve për Ndërmarrjen Publike "Pastrimi"
3. Propozim Vendim për nisjen e proceduarve për themelimin e Ndërmarrjes Publike-Lokale, (NPL) në Drenas .
4. Të ndryshme.

Drenas, 13.05.2022



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës  
Milaim Hajdari



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060/04-21115 dt. 13. 05. 2022

## PROCESVERBALI

I mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të mbajtur më dt. 20.04.2022, ora 10:00.  
Mbledhjen ë kryesoi: Milaim Hajdari- Kryesues

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të Komitetit për Politikë dhe Financa ku të pranishëm ishin anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, si dhe drejtor të drejtorive komunale.

Komiteti filloi punimet më këtë:

### Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes të Komitetit për Politikë dhe Financa i mbajtur me dt. 17.03.2022.
2. Propozim-vendim për shfuqizimin e vendimit 12 nr. 462/01-47368 të datës 30.10.2020, të Kuvendit të Komunës së Drenasit.
3. Propozim-vendim për shpronësimin e njësive të ndërtesave-banesave, në parcelën nr. 743-30, në zonën kadastrale në Glllogoc.
4. Propozim-vendim për këmbimin e pjesëve të njësive kadastrale nr.538/0 dhe 512/0 në zonën kadastrale në Nekoc.
5. Propozim-vendim për caktimin e lokacionit për zbatimin e Aktgjykimit C nr. 97/86, të dt. 06.10.1988.
6. Propozim-vendim për bartjen e të hyrave vetanake.
7. Propozim-vendim për shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të Komunës nr. 02-020/04-8424, të dt. 23.02.2022.
8. Propozim-vendim për revidimin e Planit Komunal të menaxhimit të mbeturinave për vitin 2022, i plotësuar.
9. Raporti Financiar Janar-Mars 2022.
10. Propozim për ndryshimin dhe plotësimin të Rregullores për ndarjen e subvencioneve.
11. Të ndryshme.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari-** pasi përshëndeti të pranishmit, deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të Komitetit për Politikë dhe Financa, ku prezantoi rendin e ditës, pati dhe një pikë shtesë për rendin e ditës. **1. Njoftim për plotësimin me anëtar të KKSBB-së (Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi) dhe përfaqësuesin e Komitetit për Komunitete, plotësim të vendimit me nr. 12.030-65514 të dt. 23.12.2021, dhe vendimit me nr. 12.030/01-65508 të dt. 23.12.2021.**

Pasi që nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim rendin e ditës me këtë pikë shtesë të cekur me lartë, prezent gjatë votimit ishin 6 anëtar, dhe votuan me: 05 vota (**Për**), kundër nuk pati, abstenim 1.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari-** hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës: **1. Procesverbali i mbledhjes të Komitetit për Politikë dhe Financa i mbajtur me dt. 17.03.2022.**

Pasi që nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 6 anëtar dhe votuan me: 06 vota (**Për**), kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari-** hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës: **2. Propozim-vendim për shfuqizimin e vendimit 12 nr. 462/01-47368 të datës 30.10.2020, të Kuvendit të Komunës së Drenasit.**

**Arbër Halilaj,** kjo është një pikë që ka të bëjë direkt edhe me njësinë banesore që është pronë e familjes time aty përfshihen edhe fqinjët e mi, mirëpo meqë prona është e shenjtë dhe kam të drejt me diskutua apo me e mbrojt të drejtën time në votim do të abstenoj si këtu ashtu edhe në asamble, ne po kemi shumë vendime dhe shumë shfuqizime, vendimi i cili u marrë me 30.10.2020 është vendim i ligjshëm, dhe e para që kisha kërkuar është nëse shfuqizohet ky vendim të shfuqizohet edhe vlerësimi i pronave që i ka parapri këtij vendimi. Komplet një lagje po bëhet një vlerësim për këmbim, dhe një banës që e merr me kompensua me banesa tjera. Është një vlerësim qesharak, shumë i ulët dhe është një vlerësim diskriminues.

**Hamit Haxhiu,** pajtohem me parafolësin, çfarë plani keni për banoret të cilët banojnë aty dhe çfarë zgjidhje do t'ju bëni?

**Zyrtari i Gjeodezisë dhe Kadastër Defrim Nika,** Kuvendi i Komunës së Drenasit me qellim të realizimit të interesit publik e ka marrë vendimin për këmbim mirëpo për shkak të dallimeve që ka bërë në vlerësim, aktet e vlerësimit që kanë dal shumë të ulëta në krahasim me pronat publike dhe pronat komunale dmth është e pamundur me u bë një këmbim i tillë, sepse ligji nuk i lejon procedurat e këmbimit kur ka dallime të mëdha dhe e vetmja mënyrë është me u anulua ky vendim i këmbimit dhe me shku në proces të shpronësimit.

**Florentina Elezi-Veliu,** token për të cilën po behët fjalë është e familjes time moti kur e kanë marrë, dhe nuk është shpronësua asnjëherë, lënda është në gjykatë, përderisa lënda është në gjykatë si po mundemi me marrë vendime, shfuqizime.

**Zyrtari i Gjeodezisë dhe Kadaster Defrim Nika,** sa i përket realizimit të drejtave të pronareve, është shumë më mirë me shku në proces të shpronësimit pasi që procedurat e këmbimit nuk lejohen as ankesë ndërsa me proces të shpronësimit, palët kanë të drejtë tu drejtohen gjykatës.

**Hamit Haxhiu**, pasi e ceki Florentina që është në pronësi të familjes të tyre së pari u dashtë me qenë edhe fleta poseduese edhe me e shiku a ka proces gjyqësor a nuk ka?  
Pas diskutimeve kryesuesi e hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan në këtë mënyre: *1 votë për, 2 vota abstenim, 3 vota kundër. 1 (një) anëtar u tërheq nga votimi për arsyeje të konfliktit të interesit.*

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari**- hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës: **3. Propozim-vendim për shpronësimin e njësive të ndërtesave-banesave, në parcelën nr. 743-30, në zonën kadastrale në Glllogoc.**

Pasi që nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan në këtë mënyre: *1 votë për, 2 vota abstenim, 3 vota kundër. 1 (një) anëtar u tërheq nga votimi për arsyeje të konfliktit të interesit.*

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari**- hapi diskutimin për pikën e katërt të rendit të ditës: **4. Propozim-vendim për këmbimin e pjesëve të njësive kadastrale nr.538/0 dhe 512/0 në zonën kadastrale në Nekoc.**

**Zyrtari i Gjeodezisë dhe Kadaster Defrim Nika**, kjo pjesë i përmbush gjitha kriteret për këmbim, sipërfaqja është e njëjte, parcelat janë në kufijtë kadastral njëra me tjetrën dhe kjo behet me qellim të rregullimit të infrastrukturës, ka kërkesë nga pala, kanë dal në teren gjeodetet profesioniste e kanë shiku gjendjen dhe gjithçka është në rregull.

**Arbër Halilaj**, a ka ndonjë kontestim prej pronareve të këtyre parcelave për këtë këmbim?

**Hamit Kastrati**, pala e cila ka kërkuar për këmbimin e parcelave është se jemi duke e rregulluar një rrugë, ku kanë kërkuar disa lagje të behet hapja e asaj rruge, dhe për mos me e bërë rrotull rrugën, pala ka kërkuar nëse doni me bërë me shkurt me hi nëpër prona tyre edhe ata po e lirojnë parcelën e tyre dhe po bëjmë këmbim të parcelave.  
Pas diskutimeve kryesuesi e hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan në mënyre unanime. Këtë pikë e rekomanduam për kuvend.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari**- hapi diskutimin për pikën e pestë të rendit të ditës: **5. Propozim-vendim për caktimin e lokacionit për zbatimin e Aktgjykimit C nr. 97/86, të dt. 06.10.1988.**

**Arbër Halilaj**, nëse ka kontestim nga kushdo qoftë, dhe ka ndonjë procedure qoftë padi apo procedurë gjyqësore, nuk po them të anulohet si pikë por kërkoj të shtyhet për një kohë tjetër kur të merret ndonjë vendim, pse është kaq urgjente që ky vendim të zbatohet pikërisht tani, nëse komasacioni nuk e lejon, kërkoj që për asamble me e sjellë një dokument me shkrim që shkaku i komasacionit nuk e lejon, me e pas një arsyetim me shkrim jo vetëm fjale. Unë jam kundër që kjo pikë me e dërgua në asamble përderisa ka kontest gjyqësor.

**Hamit Haxhiu**, e kam marrë edhe e kam studiuar mirë këtë lëndë, pasi që është vendim i prerë i gjykatës si shkon në asamble komunale, sa kam informata vendimet e prera të gjykatës nuk shkojnë as në kuvend, në vitin 2014 komuna ia ka dhënë atë pronë pronarit dhe kërkon të njëjtit pronar që t'i kthehet toka, apo me ia kompensua atë pronë, materialin që e posedojmë ne nuk kemi aktvendim nga gjykata komunale e Drenasit. Unë jam kundër që kjo pike e rendit të ditës të kalon në kuvend, Komiteti për Politike dhe Financa nuk e rekomandon më shku si pike e rendit të ditës për kuvend.

**Zyrtari i Gjeodezisë dhe Kadaster Defrim Nika**, për me ia caktua pronën duhet një vendim i kuvendit komunal, atij i mungon edhe vendimi i kuvendit komunal për me ia caktua pronën me komasacion pronarit, në bazë të këtij vendimi ne i kemi caktuar tri lokacione janë afër njëra tjetrës dhe duhet një vendim i kuvendit.

**Hamit Haxhiu**, nëse komuna ia ka dhënë pronën në vitin 2014 e ju kërkoni prapë me e rikthyer atë pronë dhe me e zëvendësua dikun tjetër, ju si drejtori nuk jeni komplet me material, dokumentet që i kemi ne përpara nuk e kemi aktvendimin nga gjykata komunale e Drenasit ndërsa pronari e ka aktvendimin, ju ne material nuk na keni sjellë.

Pas diskutimeve kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: u votua me vërejtje që për mbledhjen e kuvendit me sjelle material shtesë për këtë pikë të rendit të ditës.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari**- hapi diskutimin për pikën e gjashtë të rendit të ditës: **6. Propozim-vendim për bartjen e të hyrave vetanake.**

**Drejtori i Financave-Shyqiri Bublatku**, jep disa sqarime rreth kësaj pike të rendit të ditës.

Pasi që nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan në këtë mënyrë: **7 vota për, 0 vota abstenim, 0 vota kundër.**

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari**- hapi diskutimin për pikën e shtatë të rendit të ditës: **7. Propozim-vendim për shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të Komunës nr. 02-020/04-8424, të dt. 23.02.2022.**

Pasi që nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan në këtë mënyrë: **7 vota për, 0 vota abstenim, 0 vota kundër.**

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari**- hapi diskutimin për pikën e tetë të rendit të ditës: **8. Propozim-vendim për revidimin e Planit Komunal të menaxhimit të mbeturinave për vitin 2022, i plotësuar.**

**Drejtoresha për Shërbime Publike dhe Emergjente-Lumnije Krapë**, ky propozim vendim me herët ka qenë vlefshmëria e planit të menaxhimit të mbeturinave, e në bazë të ligjit për menaxhimin e mbeturinave parashihet edhe fjala revidim, Ministria e Planifikimit Hapësinor ka kërkuar që fjalën vlefshmëri me e zëvendësua me fjalën revidim.

Pasi që nuk pati diskutime tjera, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan në këtë mënyrë: **7 vota për, 0 vota abstenim, 0 vota kundër.**

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari**- hapi diskutimin për pikën e nëntë të rendit të ditës: **9. Raporti Financiar Janar-Mars 2022.**

**Drejtori i Financave-Shyqiri Bublatku**, Raporti Financiar Janar-Mars 2022, parasheh që kryetari i komunës duhet brenda 3 muajve të parë të përgatitë një raport ku i njofton asamblenë komunale me procesin e shpenzimit gjegjësisht me realizimin e të hyrave, shpenzimin e buxhetit. Sa i përket të hyrave vetanake kemi pas rënies duke e krahasuar me

vitin e kaluar kjo ka ndikuar heqja e vërtetimit për regjistrimin e automjeteve të cilën niveli qendror e ka heq, dhe kjo ka ndikuar.

Pasi që nuk pati diskutime tjera, vërejtje apo sugjerime KPF-ja e rekomanduan për kuvend edhe këtë pikë të rendit të ditës.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari-** hapi diskutimin për pikën e dhjetë të rendit të ditës: **10. Propozim për ndryshimin dhe plotësimin të Rregullores për ndarjen e subvencioneve.**

**Zyrtare në Drejtorinë e Arsimit Laura Vrellaku-** sa i përket kësaj pike neni 7 të rregullores që është paraparë lidhur për ndarjen e subvencioneve në nivel të Drejtorisë të Arsimit është paraparë për bursa për nxënësit e shkollave të mesme dhe për nxënësit e dalluar të vitit, i kemi disa pika të përfshira është e përcaktuar edhe shuma dhe çdo gjë është e përcaktuar të miratohet mbi bazën e buxhetit. Qëllimi ynë ka qenë ndarja e këtyre bursave apo subvencioneve qëllimi i ngritjes së cilësisë në arsim.

Pasi që nuk pati diskutime tjera, vërejtje apo sugjerime KPF-ja e rekomanduan për kuvend edhe këtë pikë të rendit të ditës, dhe e votuan me vota unanime.

Njoftim për plotësimin me anëtar të KKS-së (Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi) dhe përfaqësuesin e Komitetit për Komunitete, plotësim të vendimit me nr. 12.030-65514 të dt. 23.12.2021, dhe vendimit me nr. 12.030/01-65508 të dt. 23.12.2021. Rekomandohet për kuvend.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari-** hapi diskutimin për pikën e njëmbëdhjetë të rendit të ditës: **11. Të ndryshme**

**Azemine Bujupi-Gjoka,** ne jemi informuar në shkolle, dhe kemi bërë përgatitjen që nxënësit me i dërguar në vende të ndryshme për me e realizua praktiken e lendeve profesionale, ne kemi marrë informacione se e keni ndërpre kontratën me atë që e ka fituar tenderin për transport, kërkoj një sqarim.

**Hamit Haxhiu,** ne jemi në dijeni që shumë nxënës kanë fituar bursa për këtë vit, kërkoj listën e atyre nxënësve që e kanë fituar bursën dhe atyre që ju ka refuzuar bursa.

**Arbër Halilaj,** e kam bërë një kërkesë për udhëtimin e nxënësve, dhe mundësinë e subvencionimit për arsyeje siç deklarohen prindërit e fshatit Bytyq është shumë e pa përballueshme për ata. A ka ndonjë mundësi të subvencionimit të udhëtimit të shpenzimeve të organizuar për nxënës?

**Drejtoresha për Shërbime Publike dhe Emergjente-Lumniye Krap,** një përgjigje të cilën me jeni adresuar me imell e keni përgjigjen në imell, ndërsa nëse e keni fjalën për subvencionim për nxënës nuk është në domenin e drejtorisë time, është në domenin e Drejtorisë së Arsimit.

**Hamit Haxhiu,** kërkoj nga drejtoria për shërbime publike dhe emergjente që të behet një trotuar në fshatin Poklek është në pyetje 150 m nga uji i thartë deri të shtëpia e masakrës . Kërkesa tjetër është banoret e Poklekut çdo herë kanë problem për me shku në Drenas po duhet me ec nëpër asfalt, a ka ndonjë mundësi me u ndërtua një urë apo diçka ?

Drejtoresha për Shërbime Publike dhe Emergjente-Lumnije Krapë, do t'i adresoj këto çështje mirëpo nuk janë në domenin tim, janë për Drejtorinë e Infrastrukturës.

Pasi që nuk pati diskutime tjera kryesuesi e konsideroj të mbyllur mbledhjen e KPF-së.  
Mbledhja përfundoj rreth orës: 11:45 min.


Procesmbajtëse:



Liridona Fejza-Ajazi



Kryesuesi i Kuvendit Komunal



Milaim Hajdari



## Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

*Qeveria - Vlada - Government*

**Komuna/ Opstina/ Municipality Drenas (Glllogoc)**

**Zyra e Kryetarit**

01 Nr.020/04 - 20867 Dt. 12.05.2022



Në bazë të nenit 5, pika 5.2, të Ligjit për Ndërmarrjet Publike me nr.03/L-087 dhe nenit 72, pika 72.2 nënpika (k) e Statutit të Komunës së Glllogocit, i dt. 16.09.2008, Kryetari i Komunës së Glllogocit, nxjerr këtë:

### PROPOZIM-VENDIM

**Për formimin e Komisionit Komunal të Aksionareve për Ndërmarrjen Publike “PASTRIMI”**

#### Neni I

Me këtë Propozim-Vendim formohet **Komisioni Komunal të Aksionareve për Ndërmarrjen Publike “PASTRIMI” i komunës së Drenasit**

#### Neni II

Në kuadër të këtij Komisioni Komunal të Aksionareve për Ndërmarrjen publike, në bazë të nenit 5, pika 5.2, në përbërje duhet të jenë:

- a. Një anëtar i emëruar nga Kryetari i komunës dhe
- b. Dy anëtarë të emëruar nga Kuvendi i komunës

### Neni III

Detyrat dhe përgjegjësit e Komisionit Komunal të Aksionareve në bazë të nenit 7, pikat (7.1-7.3) janë si me poshtë:

1. Komisioni Komunal i Aksionareve ka të drejtë të veproj në emër të komunës në përputhje me ligjin për shoqëritë tregtare, se si do të ushtroj të drejtat e aksionarit të komunës në një çështje të caktuar
2. Aksionari(ët) e një NP do të ushtrojë mbikëqyrje të vazhdueshme dhe rigoroze të veprimtarisë së Bordit të Drejtorëve dhe Komisioneve të Auditimit të NP-së në fjalë,
3. Nëse performanca e NP-së devijon nga caqet e përcaktuara në Planin e Biznesit të miratuar nga Bordi i Drejtorëve për vitin përkatës financiar, Aksionari(ët) do të kërkojnë nga Bordi i Drejtorëve që të përgatisë dhe t'u dorëzojë atyre një raport i cili i shpjegon arsyet për performancën e dobët, dhe Aksionari(ët) do të marrin të gjitha masat e duhura korrigjuese.
4. Nëse një NP dështon në arritjen e caqeve të saj të performancës për dy vite financiare radhazi, personi(at) përgjegjës për ushtrimin e të drejtave përkatëse të aksionarit është i detyruar që të marrë parasysh shkarkimin dhe zëvendësimin e Bordit të Drejtorëve ose shumicës së anëtarëve të tij. Një veprim i këtillë mund të ndërmerret edhe në mungesë të provave bindëse të neglizhencës nga Bordi ose anëtarët përkatës të bordit, përveç nëse Aksionari(ët) konstatojnë se performanca e dobët ka ndodhur kryesisht për shkak të rrethanave ose ngjarjeve negative të paparashikueshme. Personat përgjegjës për ushtrimin e të drejtave përkatëse të Aksionarit do t'ia raportojnë çdo vendim të marrë në bazë të këtij Neni 7.3, dhe arsyet për marrjen e këtij vendimi: (i) Kuvendit, për NP-të Qendrore, ose (ii) Kuvendit përkatës Komunal, për NP-të Lokale.

#### Neni IV

Grupi punues është në këtë përbërje:

1. Lumnije Krapë, e caktuar nga Kryetari I komunës
2. \_\_\_\_\_ Kuvendi I komunës,
3. \_\_\_\_\_ Kuvendi I komunës,

#### Neni V

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Zyra e kryetarit të komunës

#### Neni VI

Ky Vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit nga kuvendi I komunës dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja.



Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci



|                      |         |            |       |
|----------------------|---------|------------|-------|
| REPUBLIKA E KOSOVES  |         |            |       |
| KOMUNA GLLOGOC       |         |            |       |
| GLLOGOC MUNICIPALITY |         |            |       |
| Januar               |         | 13.05 2022 |       |
| Nj. Org              | Nomër   | Shifra     | Vlera |
| 01-                  | 400/01- | 21037      |       |

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Komuna/ Opstina/ Municipality Drenas (Gllogoc)

Zyra e Kryetarit



Në bazë të nenit 11,12 dhe 40 të Ligjit për vetëqeverisje Lokale nr.031/L-040 dhe Ligjit nr.04/L-111 Për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike, dhe Rregulloren nr.02/2013 mbi kriteret për krijimin e ndërmarrjeve publike lokale dhe pjesëmarrja e komunave në bordet e drejtorëve të ndërmarrjeve rajonal të ujit, neni 4,5 dhe 6 dhe Rregullores (QRK) Nr. 19/2015 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores Nr.02/2013 mbi kriteret e ndërmarrjeve publike lokale dhe pjesëmarrja e komunave në bordet e drejtorëve të ndërmarrjeve rajonale të ujit: Në bazë të nenit 72, pika 72.2 nënpika (h) e Statutit të Komunës së Gllogocit, i dt. 16.09.2008, Kryetari i Komunës së Gllogocit, nxjerr këtë:

## PROPOZIM-VENDIM

**Për nisjen e proceduarve për themelimin e ndërmarrjes publike lokale, (NPL) në Drenas**

### Neni I

Me këtë Propozim-Vendim Kërkojmë nga Kuvendi Komunal në Drenas, që të merr vendim për nisjen e procedurave për themelimin e Ndërmarrjes Publike Lokale në komunën e Drenasit duke u bazuar në ligjet ekzistuese të Republikës së Kosovës.

## Neni II

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset, Kryetari i Komunës dhe Drejtorati për Shërbime Publike dhe Emergjencë.

## Neni III

**Ky Vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit nga kuvendi I komunës dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja.**

 **Kryetari i Komunës**  
**Ramiz Eladrovci**

## ARSYETIM

Qëllimi i themelimit të Ndërmarrjes Publike Lokale (NPL) në Drenas është që të menaxhohen dhe mirëmbahen hapësirat publike në komunën e Drenasit.

Duke pasur parasysh se komuna e Drenasit është ndër komunat e Republikës së Kosovës që vitet e fundit është duke bërë hapa të dallueshëm dhe përparimtar në kompletimin e infrastrukturës publike me rrugë të reja, ujësjellës dhe kanalizim, rregullimin e hapësirave publike, gjelbërimin e hapësirave publike të qytetit të cilat kërkojnë edhe mirëmbajtje dhe ruajtje të këtyre investimeve në dobi të qytetarëve.

Komuna e Drenasit po bënë përpjekje që me kapacitete dhe mundësitë buxhetore të ofroj shërbime të mira për qytetarët, andaj për të ofruar shërbim dhe mirëmbajtje të hapësirave publike kërkojmë që propozimi vendimi të aprovohet nga kuvendi komunal në Drenas.

Komuna vetëm për mirëmbajtjen e hapësirave publike kontraktonte operator ekonomik për këto shërbime:

- Mirëmbajtjen e Sheshit dhe Hapësirave publike në komunën e Drenasit;
- Larjen dhe Fshirjen e rrugëve gjatë sezonës së Verës; ,
- Mirëmbajtjen e rrugëve gjatë sezonës së Dimrit;
- Largim të deponive ilegale
- Mirëmbajtje e deponive të mbeturinave inerte

Këto projekte duke përfshirë edhe menaxhimin e mbeturinave është e domosdoshme që të kenë mirëmbajtje dhe përkujdesje institucionale nga komuna e Drenasit përmes themelimit të ndërmarrjes publike lokale (NPL). Me themelimin e ndërmarrjes publike lokale synojmë që këto shërbime të jenë të menaxhuara në mënyrën më të mirë të mundshme nga komuna e Drenasit.

Andaj kërkojmë nga asambleja që të aprovohet propozimi vendimi për fillimin e procedurave për themelimin e Ndërmarrjes Publike Lokale, për menaxhimin e hapësirave publike në Drenas.